

Ligjërata 5

Makroekonomia 1

CIKLET E BIZNESIT DHE RRYTJA EKONOMIKE

Prof.as. Avdullah Hoti

➔ Në këtë ligjëratë do të njiheni me:

→ *Konceptin e cikleve të biznesit*

→ *Fazat e cikleve të biznesit*

→ *Teoritë e cikleve të biznesit*

→ *Rritja ekonomike: funksioni i prodhimit*

HYRJE

- ⇒ **Historia: ekonomia nuk rritet dhe zhvillohet pa probleme/kriza**
- ⇒ **Vitet e ekspansionit dhe mirëqeniës ekonomike ia lënë vendin viteve të recesionit ose të panikut ekonomik**
- ⇒ **Ekonomia karakterizohet me një prirje pozitive të rritjes**
- ⇒ **Rritja ekonomike nuk arrihet asnjëherë me koeficient rritës konstant por ajo karakterizohet nga shmangie lartë-poshtë prirjes së përgjithshme të rritjes.**
- ⇒ **Luhatjet të ekonomisë ndryshojnë treguesit ekonomik:**
 - ⇒ produktit total,
 - ⇒ inflacionin,
 - ⇒ punësimin etj.

HYRJE

➔ Gjatë rënies ekonomike, firmat dhe konsumatorët i ulin shpenzimet e tyre (*shembuj për ilustrim mund të shërbejnë vitet: 1929 - 1933, 1948 - 1949, 1973 – 1974, 1981 - 1982*)


Lëvizjet herë drejtë rënies dhe herë drejtë ngritjes të treguesve ekonomik kundrejt një prirjeje të përgjithshme në rritjen ekonomike formojnë CIKLET E BIZNESIT

Shënim: çdo rënie/ngritje ekonomike nuk paraqet cikël biznesi, p.sh: rëniet shumë afatshkurtra nuk mund të karakterizohen si recesion.

FAZAT E CIKLIT TË BIZNESIT

- ⇒ Ekonomistët dallojnë katër faza të cikleve të biznesit:
 - Pika më e lartë e ciklit
 - Faza e reçesionit (rënies ekonomike)
 - Pika më e ulët e ciklit
 - Faza e ekspansionit (ngritjes ekonomike)

Figura 17.1. Ciklet e biznesit



... FAZAT E CIKLIT TË BIZNESIT

- ⇒ Si të identifikohet një cikël biznesi?
 - ⇒ Përcaktimi i fazës së recesionit - përcaktimi i periudhës kur aktiviteti ekonomik është në rënie
 - ⇒ Kur GDP bie gjatë dy tremujorve të një pasnjëshëm.
- ⇒ Nuk ka recesione (rënie) apo ekspansione (ngritje) të ngjashme, por e përbashkët (në përgjithësi) janë disa faza të njëllojta.
- ⇒ Dallimet në gjatësinë e cikleve të biznesit në mes:
 - ⇒ të vendeve
 - ⇒ Peridudhave kohore

...FAZAT E CIKLIT TË BIZNESIT

FAZA E RECESIONIT

- ➔ Moment kyç për të dalluar një cikël
- ➔ Gjatë rënies ekonomike:
 - ➔ Firmat reduktojnë prodhimin - punojnë me kapacitete jo të plota
 - ➔ Konsumatorët i ulin shpenzimet e tyre
 - ➔ Firmat largojnë punëtorë nga puna
 - ➔ Shumë firma dalin nga tregu – falimentojnë
 - ➔ Të ardhurat reale bien dhe reduktohen fitimet
 - ➔ Vështirë gjendet punë
- ➔ Recesioni mbaron me arritjen e pikës më të ulët
 - ➔ Në këtë pikë papunësia arrin nivelin më të lartë

...FAZAT E CIKLIT TË BIZNESIT

FAZA E EKSPANSIONIT


Kur përfundon faza e rënies ekonomike, fillon faza e rritjes ekonomike ose ekspansioni ekonomik:

- ➔ *Ekonomia fillon të marrë veten: GDP, punësimi, etj.*
- ➔ *Firmat zgjërojnë prodhimin*
- ➔ *Konsumatorët rrisin shpenzimet dhe konsumin*
- ➔ *Investimet e firmave rriten dhe fitimet gjithashtu*
- ➔ *Pika më e lartë arrihet atëherë kur ekonomia është në “boom”*

...CIKLET E BIZNESIT – MODELI KEJNSIAN

- ➔ Ciklet e biznesit dhe AD
- ➔ Ekuilibri afatshkurtër (pika B)
- ➔ Reçesion ekonomik:
 - AD zhvendoset majtas (Pika C)
 - Ulet Q në Q' dhe P në P'
- ➔ Ekspansion ekonomik
 - AD zhvendoset djathas

Figura 17.2: Hendeku i prodhimit në modelin kejnsonian



- ➔ Kjo lidhje shprehet përmes:

LIGJIT TË OKUNIT i cili thotë:

Për çdo 2% rënje të GDP nën nivelin potencial, papunësia rritet me 1%.


P.sh. nëse GDP aktual bie nga 100% në 98% të nivelit të GDP potencial,

papunësia rritet me 1% (formula)

...CIKLET E BIZNESIT – MODELI KLASIK

- ➔ Ekuilibri (pika A)
- ➔ Reçesion ekonomik:
 - AS zhvendohet majtas (pika B) për shkak të goditjeve në ofertë (shembuj të tillë)
- ➔ Çmimet rriten dhe bie Q
- ➔ Pra ciklet e biznesit spjegohen me lëvizjen në AS
- ➔ Teoria e cikleve reale të biznesit: lëvizjet në AD nuk ndikojnë në GDP, por vetëm lëvizjet në AS
 - p.sh. kostot e punës ose propduktiviteti, shembuj....

Figura 17.3: Hendeku i prodhimit në Modelin klasik



TEORITË E CIKLEVE TË BIZNESIT

- ⇒ Ekzistojnë teori të shumta që i shpjegojnë ciklet e biznesit. Dallimet janë mbi atë se kush i shkakton ciklet e biznesit
- ⇒ Teoria monetariste: ciklet e biznesit vijnë nga lëvizjet në ofertën monetare dhe kreditit:
 - ⇒ efekti në normë të interesit, efekti në AS
- ⇒ Teoria teknologjike: ciklet e biznesit vijnë nga inovacionet e rëndësishme teknologjike:
 - ⇒ p.sh. zbulimet, efekti në AS
- ⇒ Teoria psikologjike: ciklet e biznesit shpjegohen me optimizmin dhe pesimizmin e agjentëve ekonomik (efekti në AD)
- ⇒ Teoria e konsumit të pamjaftueshëm: gjithçka shpjegon me prirjen për kursim, e cila sjell, si pasojë që kursimet të jenë më të mëdha se investimet

...TEORITË E CIKLEVE TË BIZNESIT

Në përgjithësi të gjitha teoritë ndahen në dy grupe:

→ TEORI EKSTERNALE

→ TEORI INTERNALE

⇒ Teoritë eksternale: ciklet e biznesit spjegohen nga faktorë nga jashtë sistemit ekonomik:

⇒ ndryshimi i klimës, luftrat, zgjedhjet elektorale, zbulimet e ndryshme, zbatimet e teknologjisë, etj.

⇒ Teoritë internale: ciklet e biznesit spjegohen nga faktorë nga brenda sistemit ekonomik:

⇒ ekonomia vetëvetiu luhetet dhe rrjedhat përcaktohen nga brenda sistemit

...TEORITË E CIKLEVE TË BIZNESIT

⇒ Teoria (eksternale) e cikleve politike të biznesit:

- politika makroekonomike pëcaktohet nga zyrtarët e zgjedhur të cilët i përdorin instrumentet politike
- Zyrtarët tentojnë të rizgjedhen
- Ata e përdorin ndikimin e tyre në politikat makroekonomike
- Votuesit dëshirjnë papunësi të vogël dhe rritje ekonomike
- Cikli i zgjedhjeve përputhet me ciklin e biznesit

...TEORITË E CIKLEVE TË BIZNESIT

⇒ Teoria (eksternale) e cikleve politike të biznesit:

→ Pas zgjdhjeve: politikë e shtrënguar ekonomike

→ Recesion dhe rënie e AS

→ Pak para zgjedhjeve: politikë ekonomike ekspansioniste

→ Reduktohen taksat

→ Rriten shpenzimet qeveritare

→ Bindin bankat që të ulin normën e interesit

→ Reduktohet papunësia, rritet prodhimi

→ Votuesit shkojnë para kutive të votimit me këto zhvillime në mendje

...TEORITË E CIKLEVE TË BIZNESIT

⇒ Investimet dhe ciklet e biznesit

→ Investimet kanë rol kyç në përcaktimin e cikleve të biznesit

→ Roli i investimeve spjegohet përmes:

→ Akseleratorit dhe multiplikatorit (spjegimi)

MULTIPLIKATORI

– Rritja e investimeve çon në rritjen e prodhimit

→ Rriten të ardhurat dhe për shkak të akseleratorit rriten mëtej investimeve (formula: $Y_t - Y_{t-1}$)

→ Kjo përmes multiplikatorit çon në rritjen e mëtejme të të ardhurave

→ **Shembulli:** Rriten investimet=>Rritet prodhimi=>rriten të ardhurat=>rriten investimet=>rritet konsumi e kështu me radhë.....

→ E gjithë kjo rrit optimizmin ekonomik që çon në rritjen e mëtejme të prodhimit, të të ardhurave dhe investimeve

→ Kështu, rritja e investimeve (akseleratori) dhe rritja e konsumit (multiplikatori) forcojnë njëra tjetrën.

...TEORITË E CIKLEVE TË BIZNESIT

Por:

- Faktorët e prodhimit janë të kufizuar dhe prodhimi nuk rritet pafundësisht
 - Prodhimi do të rritet më ngadalë dhe më pas do të zvogëlohet
- Duke ndjekur parimin e akseleratorit, investimet do të bien
 - ngase bie prodhimi dhe kështu të ardhurat
- Konsumi do të bie dhe kjo shpie tek një pesimizëm ekonomik
- Kështu: Vie faza e reçesionit për shkak se:
 - ulen investimet - akseleratori dhe
 - ulet kërkesa për konsum – multiplikatori
- Por, kjo rënie ka një kufi pasi investimet negative duhet të zëvendësohen:
 - Makinat duhet të zëvendësohen
 - Kjo çon në rritjen e të ardhurave
 - Dhe kështu fillon cikli nga e para













...TEORITË E CIKLEVE TË BIZNESIT

⇒ Kështu:

Bashkëveprimi në mes të akseleratorit dhe multiplikatorit ndihmon për të spjeguar:

- fazat e ekspansionit dhe recesionit si dhe
- kalimi nga recesioni në ekspansion dhe anasjelltas

PËRMBLEDHJE: CIKLET E BIZNESIT

	Ekspansioni	Recesioni
GDP		
Papunësia		
Inflacioni		
Norma e interesit		
Produktiviteti		
Deficiti Buxhetor		

RRITJA EKONOMIKE FUNKSIONI I PRODHIMIT

- Pavarësisht cikleve të biznesit ekziston një tendencë e përgjithshme e rritjes ekonomike/ekspansionit të GDP
- Në periudha afatshkurta ekonomia karakterizohet me një të një nga 4 fazat e ciklit të biznesit
- Por në periudha afatgjata ekonomia karakterizohet me tendencën drejt rritjes ekonomike (**figura e CB në afat të gjatë**)
- Rritja ekonomike: objektivë qendrore stabilizuese makroekonomike për të gjitha nivelet e vendimmarrjes
- Analizat e rritjes ekonomike tentojnë të identifikojnë faktorët që çojnë në rritje ekonomike në afat të gjatë
 - Pasi AS përcakton produktin potencial, atëherë identifikohen faktorët që rrisin AS

RRITJA EKONOMIKE FUNKSIONI I **PRODHIMIT**

- ➔ Rritja ekonomike konsiston në rritjen e GDP potencial
 - ➔ Kurba e mundësive të prodhimit zhvendoset

- ➔ Rritja ekonomike rrit standardin e jetesës

- ➔ Rritja ekonomike reale:
 - ➔ rritja e prodhimit për kokë/frymë banori e jo totali i prodhimit:
 - ➔ arsyeja: raporti rritje e popullsisë me rritjen e prodhimit mund të jetë e ndryshueshme

RRITJA EKONOMIKE FUNKSIONI I PRODHIMIT

⇒ Spjegimet e hershme të ekonomistëve për rritjen ekonomike:

⇒ **Adam Smith:**

- ⇒ puna merret parasysh, kurse toka është e mjaftueshme dhe e lirë.
- ⇒ Çmimi përcaktohet nga niveli i punës së angazhuar.
- ⇒ Dobësia: nuk mirret parasysh se popullsia rritet në vazhdimësi kurse toka mbetet e njëjtë

⇒ **Tomas Maltus:**

- ⇒ rritja e pabalacuar - rritja e popullsisë me progresion gjeometrik
- ⇒ kurse rritja e prodhimit dhe të ardhurave me progresion aritmetik.
- ⇒ Dobësia: nuk mirret parasysh progresi teknologjik ku si rezultat prodhimi tejkalon rritjen e popullsisë

...RRITJA EKONOMIKE DHE FUNKSIONI I PRODHIMIT

- Funkzioni i prodhimit shpreh lidhjen në mes të burimeve të përdorura dhe prodhimit të prodhuar gjatë një periudhe kohore
 - Lidhja e tillë mund të jetë për një mall apo për gjithë ekonominë
- Në nivel të ekonomisë, na intereson lidhja në mes të GDP dhe faktorëve të nevojshëm për të prodhuar atë:

$$Y = f (N, R, K, T)$$


Si ndryshon Y (GDP) si rezultat i ndryshimit të punësimit (N), duke mbajtur të pandryshuar nivelin e resurseve natyrore (R), pajisjet kapitale (K) dhe gjendjen e teknologjisë (T)

...RRITJA EKONOMIKE DHE FUNKSIONI I PRODHIMIT

- Grafikisht kjo paraqitet në Fig. 17.4 (slajdi ne vijim)
- Sa më shumë individë të punësohen, rritet GDP
- Por jo në mënyrë proporcionale,
 - sepse në periudha afatshkurtra vepron ligji i të ardhurave zbritëse
- Si rritet GDP nga GDP_1 në GDP_2 ?
 - Duke rritur punësimin nga N_1 në N_2
- Duke ndryshuar K , T ose kombinimin e tyre
 - > Zhvendoset kurba e funksionit të prodhimit
 - > Kjo tregon se ka një përmirësim të efikasitetit/produktivitetit në ekonomi

...RRITJA EKONOMIKE DHE FUNKSIONI I PRODHIMIT

Figura 17.4: Kurba e funksionit të prodhimit në periudha afatshkurtra



...RRITJA EKONOMIKE DHE FUNKSIONI I PRODHIMIT

- Mënyrë tjetër për paraqitjen e funksionit të prodhimit është paraqitja e lidhjeve:

- Sasia e kapitalit për punëtorë **K/N**
- Sasia e prodhimit për punëtorë **GDP/N**

- Përmes kësaj matet produktiviteti i punës:

- Përdorimi efikas i punës në procesin e prodhimit
- Produktiviteti matet përmes:

Prodhimit për orë pune = $\text{GDP/orët e punës për prodhimin e tij}$

Punëtorët x orët e punës = orët totale të punës në ekonomi

Prodhimi për punëtor = $\text{GDP/numri i të punësuarve}$

...RRITJA EKONOMIKE DHE FUNKSIONI I PRODHIMIT


- Produktiviteti i punës varet nga kapitali i përdorur për punëtorë në procesin e punës (K/N)
- Sa më shumë K për N , produktiviteti është më i lartë
- Kjo lejon të shprehet lidhja në mes të:
 - kapitalit për punëtorë K/N
 - produktivitetit për punëtorë GDP/N
 - Figura 17.5
 - Forma e kurbës është e njëjtë si më parë
 - > vepron ligji i të ardhurave zbritëse

...RRITJA EKONOMIKE DHE FUNKSIONI I PRODHIMIT

- **Produktiviteti rritet nëse:**
 - **Raporti K/N rritet por jo pa kufizim**
 - > kur T dhe R mbeten të kufizuara atëherë produktiviteti fillon të rritet më pak ose të bie për rritje shtesë në K/N
 - **Prodhimi rritet në dy mënyra (si më parë):**
 - > Rritet raporti K/N
 - > Rritet eficiency (rritet T).

...RRITJA EKONOMIKE DHE FUNKSIONI I PRODHIMIT

Figura 17.5: Paraqitje alternative e funksionit të prodhimit



Burimet kryesore të rritjes ekonomike

1. Rritja e ofertës së punës e cila çon në rritjen e prodhimit
2. Rritja e kapitalit fizik (makineritë, pajisjet, instrumentat, ndërtesat etj)
 - Produktiviteti rritet kur K rritet më shumë se N
 - Por kjo vie duke u zvogëluar kur faktorët e tjerë mbeten të pandryshuar
3. Përmirësimi i teknologjisë
 - Zhvendosja e kurbës së funksionit të prodhimit
 - Përmirësimi i T e rrit prodhimin për të njëjtën sasi N , K dhe R
 - Ndryshimet teknologjike vien si rezultat i
 - > Risive në fushën e kërkimeve shkencore

Konceptet kyçe

- **Ciklet e biznesit**
- **Fazat e cikleve të biznesit**
- **Recesioni dhe ekspanzioni ekonomik**
- **Teoritë e cikleve të biznesit**
 - **Teoritë eksternale dhe internale**
- **Rritja ekonomike**
- **Funksioni i prodhimit (faktorët e këtij funksioni)**
- **Produktiviteti i punës**

Detyrë

- 1. Analizoni sjelljen e GDP ne Kosove gjate viteve 2001-2009 dhe diskutoni se ne cilen faze te ciklit te biznesit gjendet ekonomia e Kosoves?**
- 2. Gjeni raportin GDP/Punetore ne Kosove per periudhen 2001-2009 (si mates i produktivitetit te punes) dhe diskutoni se cfare ka ndodhur me produktivitetin ne Kosove gjate ketyre viteve?**
 - A eshte ky trend ne perputhje me teorine ekonomike se renja e produktivitetit nenkupton renje ekonomike dhe e kunderta?**